

VENDIM
Nr.649, datë 11.6.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIMI I QENDRËS SË QYTETIT TË VORËS, SHESHET I, II DHE III, NË BASHKINË E VORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi i qytetit të Vorës, sheshet I, II dhe III, në bashkinë e Vorës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Vorës.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 368 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë) m², truall, dhe 563 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) m², objekt, pronë private, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 16 903 516 (gjashtëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Vorës, planifikuar në buxhetin e vitit 2009.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Vorës.
6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Vorës, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurive, me sipërfaqe 368 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë) m², truall, dhe 563 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) m², objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Vorës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Vorës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.
10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Vorës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR “SISTEMIMIN E QENDRËS SË QYTETIT TË VORËS, SHESHIT I, II DHE III”, NË BASHKINË E VORËS

Nr.	Emrat e pronarëve	Sip. truall i lirë + truall nën objekt m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Sip. objekti m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e objektit lekë	Amortizimi në vite i objektit lekë	Vlera totale lekë	Dokumentacioni i pronësisë
1	Kujtim Dervishi	368	3773	1388464	368	34133.5	12561130	2122831	11826763	Vërtetim pronësie
2	Mustafa Çaushi	-	-	-	195	30414.28	5930786	854033	5076753	Proces regjistrimi
	Shuma totale	368			563				16903516	

